

VENDIM
Nr.72, datë 24.6.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP MES FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË
DHE FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.36, datë 21.3.2008 “Për fillimin e procedurave për miratimin e marrëveshjes tip mes furnizuesit publik me shumicë dhe furnizuesit publik me pakicë”, pikës 4.13, germa “A”, pika 2, të modelit të tregut të energjisë elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi draftin e kontratës tip mes furnizuesit publik me shumicë dhe furnizuesit publik me pakicë të përgatitur nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim,

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës tip mes furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike dhe furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike (marrëveshja bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta